

---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**

Nr.     prot.

Vlorë, më .04. 2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS** “Sherbim Pastrimi Njesia Administrative Novosele ,Qender Vlore, dhe Shushice per vitin 2023

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) 1964000-4

Fondi limit:**31,467,958<sup>4</sup>**( **Tridhjetë e njemilion e katerqind e gjashtedhjetë e shtate mije e nenteqind e pesedhjetë e tete pike kater ) Lekë Pa TVSH**,përnevojatëBashkise "Vlorë, tëjetëpër 12 muaj ose 365 dite.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara,ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurimoferte, sipasShtojcës 3 të DT;*

*b. Formularipërmbledhësisivetdeklarimit, sipasshtojcës 9 të DT;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërmebazohennënenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullavetëprokurimitpublik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.  
-Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit Kodi II.8.A. me qellim pastrimin dhe larjen e konteniereve  
  
-Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license D.D.D lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit Kodi II.8.B me qellim dezinfektimin e konteniereve.

Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë merre te pakten nje muaj perpara dates se zhvillimit të tenderit.

Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë merre te pakten nje muaj perpara dates se zhvillimit të tenderit.

Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 45001:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurise në punë”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë merre te pakten nje muaj perpara dates se zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbimet të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga entiteti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
  - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori/ëkonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht **11 (njëmbëdhjetë)** persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

Nr.	Stafi	Nr.
1	Drejtues Teknik- me profil Menaxhim Mjedisi	1 (një)
2	Pergjegjes me profil Menaxhim Mjedisi	1 (një)
3	Punonjës shërbimi	7 (shtate)
4	Punonjës shërbimi/Shofer përdrejtimin e mjeteve të kërkuara	2 (dy)
	<b>Totali i punonjësve</b>	<b>11 (njëmbëdhjetë)</b>

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Për Drejtuesin Teknik, me profil - Menaxhim Mjedisi OE duhet të paraqes:
  - Diplomë me profesion Menaxhim Mjedisi.
  - Kontrate pune perkatese.
  - Libreze pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën perkatese.
  - Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.
- Per punonjësin Pergjegjes me profil Menaxhim Mjedisi, te paraqitet:
  - Diplomë me profesion Menaxhim Mjedisi .
  - Duhet të ketë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e – albania.
  - Kontrate pune perkatese.
  - Libreze pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën perkatese.
  - Pergjegjesit nuk duhet te jene te angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.
- Per punonjësit punonjes shërbimi, te paraqitet vetem kontrate pune perkatese (dy prej tyre te jene te pajisur me Leje Drejtimi në përputhje me mjetet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

**Shënim:** Punonjës Shofer, mund të jetë cilidongapunonjësit e OE, mjaftondy prej tyre të jenë të pajisur me Leje Drejtimin në përputhje me makineritë/pajisjet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit mëposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes

**Shënim:** Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar te cdo punonjesi prane AK.

**\*Shenim 4.1:**

Me qellim garantimin e gjithë perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

**Stafi qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

**Stafi i percaktuar ne tabelën e mesiperme me nr 2, 3, 4 te cilet do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor, per zbatimin e kesaj kontrate, nuk duhet te jene te angazhuar ne kontrata te tjera, deri ne perfundim te kontrates. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuuesi Ligjor i shoqerise.**

**Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.**

*Argumentimi: Nëbazëtë pikës 4, tënenittë 77, tëligjitnr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokuriminpublik” dhenenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e Rregullavetë Prokurimit Publik”, me anëtëkëtitjriterikërkohetqëoperatorëtekonomikëtëdëshmojnëqëkanëstafin, personelin e nevojshëmtekualifikuarpërrealizimin me sukses tëkontratës.Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane shërbim pastrimi. Stafi i kerkuar, eshte percaktuar nga vete autoriteti kontraktor,ky numer minimal ështëkërkuar duke u bazuar ne nevojen per kryerjen e shërbimevesidhenatyrendhenumrin e shërbimeveqekerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes per realizimin e objektit. Operatori ekonomik duhet te disponoje nje person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit te pastrimit. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet.Ky numer minimal punonjesisheshtekërkuar, duke mbajturparasyshndarjen ne dyturne.*

3. Operatoriekonomikduhettëdeklaroje se disponon, makinerite, dhepajisjet, simëposhtë:

Nr	Emriimjetit	Njësia	Sasitëminimale	Statusi
1	Makineteknologjiketransportuese e mbetjeve urbane, me kapacitetmbajtes jo me tevogel se 4 ton, me ngjeshje.	copë	3 (tre)	Në pronësi ose me qira
2	Makine per larjen e rrugeve (Autobot) tepajisur me pompe per larjen e rrugeve me presiondhekonteniereve, me kapacitetmbajtes 9000deri 10000 litraujë me pajisjeperpara per larje.	copë	1 (nje)	Nëpronësiose me qira
3	Kamioncine me kapacitetmbajtes 2 ton.	copë	1 (nje)	Nëpronësioseme qira

**Shënim 5.1:**

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit duhet te paraqesi prane AK dokumentacionin për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Autoriteti Kontraktor, pas dorezimit te dokumentacionit te mesiperme do te verifikoj prane ambienteve te operatorit disponueshmerine e pajisjeve e deklaruarra.

**Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

**Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

4. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

**Shënim:** Rastet kur konstatohen deklarata të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.